

VENDIM
Nr.282, datë 18.3.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR MILOT-RRËSHEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9636, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme (objekte), që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objektet, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 4 857 712 (katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë.
 4. Ky fond të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 144 000 (njëqind e dyzet e katër mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 6. Shpronësimi të fillojë më 20.3.2009 dhe të përfundojë më 20.6.2009.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E OBJEKTEVE NË PRONËSI PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT MILOT-RRËSHEN**

Nr.	Lloji i objektit	Emri i pronarit	Segmenti	Vlera lekë
1.	Shtëpi banimi	Fran Mark Karagjozi	Milot-Rrëshen	3499765
2.	Mur guri	Lek Bitraj	Milot-Rrëshen	43063
3.	Mur rrethues	Zef Llesh Fusha	Milot-Rrëshen	514319
4.	Kalçeto	Arben Bitri	Milot-Rrëshen	800565
		Totali		4857712